

Akt Themelimi

i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

“Vivi Lab” SH.P.K

Neni 1 Formimi

Sot në Tiranë më datë 02.12.2020, (dymijë e njëzetë) pala si më poshtë vijon:

1. **Patrik Tola**, shtetas shqiptar, i datëlindjes 04.02.1994, lindur në Korçë, banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. J40204074F.

ka vendosur të nënshkruajë këtë Akt Themelimi, të themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, “Vivi Lab” sh.p.k, me Ortak të Vetëm shtetasin Patrik Tola.

Kjo shoqëri krijohet në bazë të Ligjit Nr.9901, dt.14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare” si dhe Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit” dhe është themeluar me vullnet të lirë.

Neni 2 Selia

Selia e shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “Vivi Lab” SH.P.K është në adresën: Njësia Administrative Nr,7, Rruga "Muhamet Gjollësja", Hyrja 1, Nr Pasurie 4/132-N5, Vol 19, faqe 197, ZK 8260, Tiranë.

Neni 3 Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “Vivi Lab” shpk është pa afat nga momenti i regjistrimit të saj pranë QKB Tiranë.

Neni 4

Objekti i Veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë “Vivi Lab” sh.p.k është:

- Tregetim me shumice e pakice si, syze optike, syze dielli, lente optike, lente kontakti, lente kozmetike;
- Ofrimi i shërbimit të vizitave optometrike;
- Eksportimi, Importimi dhe shitja e pajisjeve mjekësore;
- Eksportimi, Importimi dhe shitja e aksesorëve, konfeksioneve, veshjeve dhe prodhimeve industriale të ndryshme;
- Shoqëria për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, bashkëpunon dhe ndërmjetëson, me persona juridik e fizik, që kanë të njëjtin objekt veprimtarie ose të ngjashëm me të.

Neni 5

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë “Vivi Lab” sh.p.k është 10.000 (dhjetë mijë) lekë; i ndarë në 1 kuotë, e cila i përket Ortakut të Vetëm të kësaj shoqërie, si më poshtë:

1. Patrik Tola, në masën 100% (njëqind përqind)

Ky kapital do të ngurtësohet në bankë mbasi shoqëria të rregjistrohet në QKB. Kapital i cili mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrë ortaku i vetëm i shoqërisë, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

Neni 6

Organet e Shoqërisë dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë “Vivi Lab” sh.p.k janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendimmarrës.
- Administratori.

Shoqëria do të drejtohet nga **Administratori i saj z. Patrik Tola** i cili është edhe Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

Kohëzgjatja e administratorit është 5 (pese) vjet.

Neni 7

Organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë e juridikë, vendas apo të huaj, shprehen në Status që bashkë me Aktin e Themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

Neni 8

Shoqëria ka vulën e saj dhe veprimtarinë e saj shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statuti, si dhe legjislacionit shqiptar. Në të kundërt, zgjidhen në rrugë gjyqësore, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Vivi Lab" sh.p.k në QKB. Në këtë ditë, shoqëria "Vivi Lab" sh.p.k njihet si person juridik.

Ky Akt Themeli nënshkruhet nga Ortaku i Vetëm i Shoqërisë më Përgjegjësi të Kufizuar,

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë "Vivi Lab" sh.p.k

PATRIK TOLA

